

Dëshmorët Akindini, Pegasi, Afthoni, Elpidofori dhe Anempodisti. Omologjet Andoni i Selanikut (ish mitropolit i Durrësit).



E enjte, 2 nëntor 2023 – Shenjtori i ditës.

Dëshmorët Akindini, Pegasi, Afthoni, Elpidofori dhe Anempodisti. Omologjet Andoni i Selanikut (ish mitropolit i Durrësit).

– DËSHMORËT AKINDINI, PIGASI, AFTHONI, ELPIDOFORI DHE ANEMPODHISTI –

Këta martirë të shenjtë ishin ofiqarë në oborrin e mbretit të Persisë Sapor II (339-379). Kur mbreti ndërmoi një përndjekje të përgjakshme kundër të krishterëve, shën Akindini, Pigasi dhe Anempodhisti, u strehuan në një shtëpi diku në qytet dhe i nxisnin të krishterët të qëndronin të fortë në besën e tyre, pa marrë parasysh rreziqet që iu kanoseshin. I kapën, i nxorën para mbretit dhe i rrahën mizorisht.

Kur mbreti blasfemoi emrin e Krishtit, iu lidh goja dhe mbeti memec nga lutjet e shenjtorëve. Por patën mëshirë për të dhe e çliruan, por tirani nuk e kuptoi këtë shenjë të fuqisë së të krishterëve. I shtrinë në shtretër hekuri të nxehtë, pastaj i zhytën në kazan me plumb të shkrirë. Nuk i cenoi asgjë, madje një nga ushtarët që rrinte pranë tyre, Afthoni, kur i pa të paprekur, u bë i krishterë. Menjëherë ia prente kokën në vend, pa i bërë gjyq.

Shenjtorët pësuan edhe tortura të tjera, gjatë të cilave Elpidofori, një nga anëtarët e rëndësishëm të Senatit, dhe 7 mijë persë u kthyen në besim. Të gjithëve ua prenë kokat. Ndërsa Akindinin, Pigasin dhe Anempodhistin i hodhën në një gropë me bisha të egra, por përsëri i ruajti hiri i Perëndisë, gjë që bëri të mundur kthimin në besim të vetë nënës së mbretit. Shenjtorët morën kurorën e martirizimit bashkë me nënën e mbretit dhe 28 shokët e tyre.

* * * * *

- OMOLOGJET ANDONI (Mitropolit i Durrësit e më pas Kryepiskop i Selanikut, + 2 Nëntor 844) -

Shën Andon Omologjeti (Rrëfyesi i besimit) është ndër figurat kryesore pohuese dhe mbrojtëse të të vërtetave të besimit orthodhoks në periudhën e dytë të luftës dhe thyerjes së ikonave (815-843), që në historinë e Kishës së Krishterë njihet Ikonomahia ose Ikonoklastia.

Ikonoklastia, që zgjati nga viti 726-843, tronditi prej dekadash unitetin e Krishterimit në Perandorinë Romake në lindje dhe perëndim (deri në vitin 1054 ishte një Kishë e vetme e krishterë në të gjithë botën).

Krishterimi nuk ishte armiqësor ndaj çdo figurimi ndjesor estetik të botës mbinatyrore. Në të vërtetë, arti i krishterë u shfaq që prej shek. I, si ndihmëse e natyrshme e tij, duke pikturuar historinë e shpëtimit, që nga Krijimi i botës deri në Ardhjen e Dytë të Krishtit. Kështu Krishterimi i dha ikonës cilësi të dyfishtë: si mjet plotësues për katekizmin e besimtarëve dhe objekt nderimi në adhurimin kishtar. Ikona mësonte shpesh të pashkolluarit, ushqente dashurinë për Perëndinë si edhe nderimin ndaj të përzgjedhurve të Perëndisë (shenjtorëve). Si objekt nderimi ajo synonte të nxiste dhe të ndriçonte devotshmërinë dhe shprestarinë e besimtarëve.

Me mishërimin e Birit të Perëndisë, duke marrë trup si ne njerëzit, bëhej e mundur që Perëndinjeriu, Jisu Krishti, të ikonizohej si njeri, pa harruar Dhiatën e Vjetër që urdhëronte të mos fantazoheshin e të ikonizoheshin gjërat hyjnore. Kështu ikona e tij nuk paraqet natyrën hyjnore, por vetëm atë njerëzore. Prandaj, ikona nderohet dhe nuk adhurohet. Ky është edhe vendimi i Sinodit të 7-të Ekumenik, që u mbledh në Nikea (sot në Turqi), në vitin 787, për të mbrojtur mësimin dhe rëndësinë e ikonave. Pra, ikona na ndihmon neve në adhurimin tonë drejtuar Perëndisë Triadik, Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë.

Për figurën e këtij pohuesi të besimit nuk kemi shumë të dhëna. Një burim tepër i rëndësishëm për jetën e tij është një fragment që ndodhet në jetëshkrimin e shenjtores oshënare Theodhora (5 prill) nga Selaniku. Andoni kishte afrimitet fisnor me Oshënaren Theodhora, e cila kishte lënë bijën e saj Theopisti, si murgeshë tek Ekaterina (motra e Shën Andonit) që ishte igumene e manastirit të vogël "Ungjillor Llukai".

Andoni pasi mësoi që i vogël Shkrimet e Shenjta dhe mori më vonë thirrjen murgjërë, e veshi veten e tij me të gjitha llojet e virtyteve, duke studiuar vazhdimisht Shkrimin e Shenjtë dhe duke nënshtruar çdo mendim në bindjen e Krishtit. Arsimimi dhe dëshira e Andonit për dituri nuk kufizohej vetëm tek tekstet e shkrimtarëve të krishterë, por zgjerohej edhe më tej në formimin e tij të përgjithshëm enciklopedik, duke e ngritur më lart nivelin e shpjegimit dogmatik.

Të gjitha këto patën si rezultat zgjedhjen e tij në fronin e Mitropolisë së Durrësit. Kjo zgjedhje mendohet të jetë bërë më përpara vitit 815, në kohën e ripërtëritjes së Ikonoklastisë (pra, në periudhën e dytë të luftës kundër ikonave), që zë fill 2 vjet pas ngjitjes së Leonit të 5-të Armenit në fronin perandorak (813-820).

Një burim mjaft i rëndësishëm për të në këtë periudhë janë letrat e shenjtorit oshënar Theodhor Studitit (11 nëntor) (†826), figurë e shquar udhëheqëse e ikonadashësve, drejtuar Andonit të Durrësit.

Në letrën e parë, 462, që i përket përpara vitit 815, Theodhori i përgjigjet Andonit për ngjarjen në lidhje me të drejtën kanonike, letër e cila karakterizohet nga një ton i ngrohtë dhe një prirje lavdërimi drejtuar personit të Andonit, duke shfaqur një vlerësim të veçantë dhe nderim për të. E njëjta frymë dallohet edhe në letrën e dytë, 542, që mendohet të jetë e vitit 826 në kohën e perandorit Mihail i 2-të.

Një informacion i ndërsjelltë për Andonin, gjatë kohës së tij në Mitropolinë e Durrësit, gjendet edhe në letrën 543 të po këtij oshënar drejtuar murgut Dionis, i cili më parë kishte pranuar këshilla prej Atit tonë, mik të shtrenjtë të Perëndisë dhe Mitropolit të Durrësit gjatë herezisë së Ikonoklastisë.

Kleriku Grigor, në jetëshkrimin e Shën Theodhorës, pas fragmentit për Andonin tregon përndjekjen e ashpër të perandorit Leont ndaj ikonodashësve dhe mes të tjerash përqendrohet tek fjalimi kundërshtues me bazë kristologjike që mbajti Andoni përpara perandorit, i cili fillon kështu:

“O perandor, unë nuk dua të përdor fjalë blasfemuese kundër Perëndisë sonë të vërtetë Jisu Krishtit, dhe as nuk dua ta ofendoj atë me vepra, ashtu siç bëjnë grupi i ikonoklastëve, të cilët nuk kanë frikë, që me guxim e fjalë të pabesa dhe arsyetime t’i japin emrin e idhullit ikonës së nderuar të Krishtit, përmes së Cilit jemi shpëtuar nga gabimi i adhurimit të idhujve.

Sepse unë e di, se nderimi i imazheve është nderimi i kushtuar atyre që janë pikturuar në to, ashtu si edhe ç’nderimi i kalon po të njëjtave imazhe...

dhe njerëzit e dinë se si t’ia japin nderimin e duhur ikonave të shenjta dhe se si përmes tyre t’ia ofrojnë nderimin dhe adhurimin Krishtit...”.

Përgjigjja e perandorit, pas pohimit të besimit (omologjisë) dhe qëndrimit të guximshëm të Andonit, ishin torturat e egra, që i sollën plagë të pashërueshme dhe tronditën shëndetin e tij dhe në fund internimin.

Pas ngjitjes të Mihailit të 2-të (820-829) në fronin perandorak, në prag të

Krishtlindjes së vitit 820, Andonin e thirrën të kthehej prej internimit, ndërsa pas 20-vjetësh e zgjedhin Kryepiskop të Selanikut.

Mirëpo koha e tij në krye të kësaj Kryepiskopate ishte shumë e shkurtër, sa që s'mundi dot të kryente as edhe detyrat e tij liturgjike kryepiskopale, përveç dorëzimit të një kleriku. Vdekja e tij oshënare ndodhi pak muaj pas Rivendosjes së Ikonave, më 2 nëntor 844.

Tregimi i klerikut Grigor vazhdon më pas me një informacion tepër të rëndësishëm për varrosjen e trupit të Andonit në kishëzën e Shën Joan Pagëzorit, ngjitur në krahun e majtë të kishës së Shën Dhimitër Mirovlitit, në Selanik. Ai përmend se pas 46 vjetësh nga vdekja e Andonit, do të varrosej një tjetër kryepiskop i Selanikut (Metodi) në varrin e tij, kjo gjë solli si rezultat zbulimin e një mrekullie përpara të gjithë të pranishmëve (mes të cilëve edhe vetë Grigori) trupin e paprishur të Andonit, i veshur me stolitë kryepriiftërore.

Në vazhdim ai përmend si të dhëna, që vërtetojnë shenjtërinë e Kryepiskopit Andon, pohimin e besimit orthodhoks dhe mësimin për nderimin e ikonave të shenjta (të cilin e vërteton me citimin e fjalimit kundërshtues ndaj perandorit Leon dhe me paprishjen e trupit të tij. Bëhet fjalë për kritere mjaft të përhapura të shenjtërimit gjatë kohës së Ikonoklastisë dhe pas saj.

Emri i Andonit është shkruar në katalogët më të rinj të shenjtorëve të Selanikut dhe në shërbesën kishtare me himne kushtuar atyre.

Ikona e vetme e njohur e Shën Andon Omologjetit ndodhet e pikturuar, në stilin e sotëm ikonografik, në një kolonë të kishës mitropolitane të Shën Grigor Pallamait, në Selanik.

Durrsakët e kujtojnë dhe e nderojnë këtë figurë historike kishtare të qytetit dhe dioqezës së tyre.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)